



www.legjislacioni.gov.al

Buletini i Njoftimeve Zyrtare I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2015 – Numri: 20

Tiranë – E hënë, 21 dhjetor 2015

PËRMBAJTJA

	Faqe
Urdhër i ministrit të Financave nr. 85, datë 9.12.2015	Për miratimin e Kodit të Etikës për Inspektorët Financiarë Publikë..... 3

**URDHËR**

Nr. 85, datë 9.12.2015

**PËR MIRATIMIN E KODIT TË ETIKËS
PËR INSPEKTORËT FINANCIARË
PUBLIKË**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës dhe në zbatim të nenit 9, pika 2, germa “c”, të ligjit nr. 112/2015, “Për inspektimin financiar publik”, ministri i Financave,

URDHËRON :

1. Miratimin e Kodit të Etikës për inspektorët financiarë publikë.

2. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen nëpunësi i parë autorizues dhe Drejtoria e Inspektimit Financiar Publik në Ministrinë e Financave.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**MINISTRI I FINANCAVE
Shkëlqim Cani**

KODI I ETIKËS

**PËR INSPEKTORËT FINANCIARË
PUBLIKË**

MISIONI

Misioni i veprimtarisë së inspektimit financiar publik është garantimi i zbatimit të ligjshmërisë në përdorimin e fondeve publike dhe dhënia e ndihmës në përmirësimin e menaxhimit financiar publik.

Realizimi i këtij misioni kërkon nga inspektorët financiarë publikë integritet, objektivitet, përgjegjshmëri, kompetencë dhe profesionalizëm, me synim shërbim produktiv dhe eficient në mbrojtje të interesave financiare të njësive publike kundrejt keqmenaxhimit të rëndë financiar, mashtrimit, vjedhjes, shkatërrimit të pronës, shpërdorimit të detyrës apo korrupsionit.

Zbatimi i akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe respektimi i parimeve dhe i rregullave të sjelljes dhe të etikës profesionale nga inspektorët financiarë publikë, rrit besueshmërinë te subjektet e inspektuara, si dhe te subjektet dhe individët që sinjalizojnë raste që shërbejnë për fillimin e inspektimit financiar publik.

BAZUESHMËRIA LIGJORE

Ky Kod hartohet në zbatim të:

- Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë;

- Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar;

- Ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”;

- Ligjit nr. 112/2015, “Për inspektimin financiar publik”;

- Ligjit nr. 9131, datë 8.9.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”;

- Ligjit nr. 9508, datë 3.4.2006, “Për bashkëpunimin e publikut në luftën kundër korrupsionit”.

QËLLIMI DHE FUSHA E VEPRIMIT

Kodi i etikës synon vendosjen dhe respektimin e rregullave të sjelljes dhe të etikës profesionale nga inspektorët financiarë publikë, gjatë përmbushjes së inspektimit financiar publik, si dhe jashtë ushtrimit të kompetencave të tyre funksionale, në pajtueshmëri me aktet ligjore e nënligjore në fushën e inspektimit financiar publik, si dhe me rregullat e etikës në administratën publike.

Përmbledhja tërësore e vlerave dhe e parimeve të këtij Kodi, duhet të udhëheqë inspektorët financiarë publikë në sjelljen dhe veprimet e tyre gjatë misioneve të inspektimit financiar publik.

Inspektorët financiarë publikë duhet të pajtohen me këtë Kod Etike, me synim nxitjen e besimit dhe të sigurisë gjatë përmbushjes së inspektimit financiar publik. Ata duhet të shikohen me besueshmëri dhe me siguri nga autoritetet ligjore në fushën e inspektimit financiar publik, nga subjektet e inspektuara dhe nga subjektet dhe individët që raportojnë raste të keqmenaxhimit të rëndë financiar, mashtrimit, vjedhjes, shkatërrimit të pronës, shpërdorimit të detyrës apo të korrupsionit.

Çdo mangësi apo shkelje në sjelljen profesionale apo në sjelljen e pahijshme në jetën personale, ndikon integritetin e inspektorëve financiarë publikë dhe vlefshmërinë e punës së tyre dhe mund të ngrejë dyshime rreth besueshmërisë së procesit të inspektimit financiar publik.

Inspektorët financiarë publikë janë punonjës të Drejtorisë së Inspektimit Financiar Publik në Ministrinë e Financave, si edhe ekspertë të jashtëm, punonjës të administratës publike ose jashtë saj, të cilët angazhohen në kryerjen e inspektimit financiar publik.

PËRMBAJTJA

Kodi i Etikës për inspektorët financiarë publikë, është tërësia e të drejtave, detyrimeve dhe



rregullave të sjelljes që çdo inspektor financiar publik duhet të përmbushë gjatë ushtrimit të detyrës, në marrëdhënie me autoritetet ligjore në fushën e inspektimit financiar publik dhe me subjektin e inspektimit, bazuar në kërkesat ligjore e nënligjore në fuqi, si edhe jashtë ushtrimit të kompetencave funksionale.

PARIMET E PËRGJITHSHME

Ky kod bazohet në parimet e përcaktuara në Kodin e Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, të grupuara në katër shtylla kryesore:

1. Integriteti:

“Inspektorët financiarë publikë duhet të jenë të drejtpërdrejtë dhe të ndershëm në të gjitha marrëdhëniet profesionale. Integriteti përbën bazën për besueshmërinë në gjykimin e tyre”.

Integriteti kërkon që inspektorët financiarë publikë:

a) Të reflektojnë standarde të larta të integritetit profesional e personal në ushtrimin e funksioneve të tyre, për të siguruar funksionimin sa më transparent, të ndershëm, të drejtë dhe të përgjegjshëm të shërbimit të inspektimit;

b) Të garantojnë mbrojtjen e interesit publik në të gjithë aktivitetin e tyre, duke shmangur çdo sjellje që mund të komprometojë integritetin dhe besueshmërinë e publikut;

c) Të shprehin në mënyrë besnike të vërtetën, pa frikë dhe pa u ndikuar nga pikëpamjet e bindjet politike, sociale, fetare apo ekonomike të personave që takojnë gjatë detyrës;

ç) Të shmangin sjellje të paqarta dhe të dyshimta, çdo diskriminim për shkak të gjinisë, racës, ngjyrës, etnisë, kombësisë, gjuhës, identitetit gjinor, orientimit të bindjeve politike, fetare ose filozofike, gjendjes ekonomike, arsimore ose shoqërore, ose për çdo shkak tjetër;

d) Të ruajnë të pastër figurën e tyre morale dhe të shmangin sjellje apo veprime, të cilat cenojnë autoritetin dhe imazhin e tyre para opinionit publik.

Integriteti i inspektorëve financiarë publikë është një përgjegjësi personale, një detyrim pa kompromis për zbatimin e kërkesave ligjore, rregulloreve, vlerave morale dhe etike. Integriteti mund të matet sipas asaj që është e ligjshme dhe e drejtë.

Inspektorët financiarë publikë, në kryerjen e misionit të inspektimit, duhet të respektojnë parimet e pavarësisë dhe të objektivitetit, të ruajnë standardet e sjelljes profesionale, të marrin vendime

në favor të interesit publik, të punojnë në mënyrë të besueshme, të ndershme dhe të përgjegjshme.

Inspektorët financiarë publikë nuk duhet të kërkojnë ose të pranojnë dhurata, favore, pritje ose çfarëdo përfitimi tjetër, si dhe premtime për to, për veten, familjen, të afërmit, personat ose organizatat me të cilat kanë marrëdhënie, që ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në paanësinë e kryerjes së detyrës, apo janë ose duket sikur janë shpërblim për mënyrën e kryerjes së detyrës zyrtare. Në qoftë se ofrohet një avantazh i padrejtë, inspektori financiar publik, duhet:

a) Ta refuzojë, pa pasur nevojë ta pranojë atë për ta përdorur si provë;

b) Të përpiqet që ta identifikojë personin që i bën ofertën;

c) Të shmangë kontaktet e gjata me personin që bëri ofertën, por dijenia e arsyes për të cilën bëhet oferta, mund të shërbejë si provë;

ç) Në qoftë se dhurata nuk mund të refuzohet që t'i kthehet dërguesit, duhet të ruhet dhe t'i raportohet menjëherë eprorit direkt;

d) Të ketë dëshmitarë, nëse është e mundur, kolegët që punojnë me të;

dh) Të raportojë përpjekjen, sa më shpejt që të jetë e mundur, tek eprori i tij;

e) Të vazhdojë punën normalisht, sidomos për problemin për të cilin avantazhi i padrejtë është ofruar.

2. Objektiviteti:

“Inspektorët financiarë publikë nuk duhet të lejojnë anshmëri, konflikt interesi apo ndikime që i mbivendosen gjykimin të tyre profesional”.

Objektiviteti kërkon që inspektorët financiarë publikë:

a) Për të formuar opinionin e tyre sa më objektiv dhe të paanshëm, duhet të sigurojnë vendosje të saktë të fakteve, të dhënave dhe të provave të informacionit të marrë nga subjekti i inspektimit apo burime të tjera;

b) Në raportimin e rezultateve të inspektimit, duhet të bazohen në hierarkinë e provave dhe të fakteve apo rrethanave të lidhura me objektin e inspektimit; përfundimet e inspektimit duhet të bazohen vetëm në fakte/dokumente/prova;

c) Nuk duhet të ndikohen nga interesi personal ose i të tjerëve në përfundimet e inspektimit financiar publik;

ç) Të gjitha subjektet e inspektimit të trajtohen në mënyrë të paanshme, të barabartë, me standarde



të njëjta, duke shmangur çdo qëndrim diskriminues;

d) Të trajtojnë me respekt dhe objektivitet të drejtat dhe detyrimet ligjore të subjektit të inspektimit;

dh) Të njohin dhe të zbatojnë me korrektësi detyrimet ligjore që lidhen me parandalimin e konfliktit të interesit, parashikuar në legjislacionin në fuqi për konfliktin e interesit, si edhe në ushtrimin e detyrave në fushën e inspektimit financiar publik, kur:

- Në tri vitet e fundit: të kenë punuar për njësinë ose për individin subjekt të inspektimit; të kenë qenë pjesëmarrës në autoritetet menaxhuese ose mbikëqyrëse të tyre;

- Bashkëshorti/bashkëshortja apo bashkëjetuesi, ose të afërmit deri në shkallë të dytë, të kenë qenë të punësuar si autoritete menaxhuese ose mbikëqyrëse të tyre”;

e) Të garantojnë mbrojtjen e interesit publik në gjithë aktivitetin e tyre, duke shmangur çdo sjellje që mund të komprometojë integritetin dhe besueshmërinë e publikut.

- Konflikti i interesave është situata në të cilën inspektorët financiarë publikë kanë një interes personal të tillë, që ndikon ose mund të ndikojë në paanshmërinë ose objektivitetin e kryerjes së detyrës ligjore në fushën e inspektimit financiar publik;

ë) Në fillim të çdo misioni të inspektimit, por edhe gjatë ushtrimit të funksionit, duhet të informojnë tek eprori direkt, nëse ndonjë marrëdhënie e drejtpërdrejtë apo e tërthortë me subjektin e inspektimit, mund të vlerësohet konflikt i mirëfilltë interesi.

- Drejtori i Inspektimit Financiar Publik duhet të bëjë kujdes për vlerësimin e pozicioneve në konflikt, për menaxhimin dhe shmangien e tyre, sepse ato mund të venë në diskutim objektivitetin e procesit të inspektimit financiar publik dhe kompetencën për gjyqime të paanshme;

f) Kanë detyrimin ligjor të shmangin çdo konflikt ndërmjet interesit të tyre privat dhe interesit publik, në ushtrimin e detyrës në fushën e inspektimit, por edhe si nëpunës civil. Kur një situatë e tillë ekziston, duhet:

- Me nismën e tyre, të ribet në dijeni menjëherë eprori direkt, për konfliktin aktual ose të mundshëm të interesave;

- Të kërkojnë zyrtarisht te Drejtori i Inspektimit Financiar Publik, tërheqja nga inspektimi.

- Të ndërmerren hapat e nevojshëm për të shmangur një konflikt të tillë;

- T’i binden çdo vendimi përfundimtar, për të mos marrë pjesë në procesin e vendimmarrjes ose të heqë dorë nga përparësitë, që shkakton konfliktin.

3. Aftësia profesionale dhe ligjshmëria:

“Inspektorët financiarë publikë duhet të zbatojnë detyrat e tyre në përputhje me aktet ligjore në fuqi, në mënyrë profesionale, të paanshme, pa diskriminim. Ata kanë detyrë të vazhdueshme përmirësimit të aftësive dhe njohurive profesionale, mbështetur në zhvillimet aktuale në praktikë, legjislacion dhe teknika”.

Parimi i aftësisë profesionale dhe zbatimi i ligjshmërisë, kërkon që inspektorët financiarë publikë:

a) Të kryejnë detyrat me profesionalizëm, me kompetencë, duke respektuar një proces të rregullt ligjor, brenda kufijve të kompetencave të tyre; të shmangin çdo veprim që diskretiton profesionin e tyre;

b) Puna inspektuese duhet të jetë e besueshme, në kohë, e dobishme, bindëse dhe e qartë;

c) Të përmirësojnë aftësitë profesionale nëpërmjet formimit profesional dhe trajnimeve të vazhdueshme, për rritjen e kapaciteteve dhe zhvillimin e aftësive profesionale, për përmbushjen e detyrës funksionale. Aftësitë dhe eksperiencat profesionale të përfituara duhet të vihen në funksion të zbatimit të detyrave dhe të përmirësimit të cilësisë së punës;

ç) Të zotërojnë njohuri të plota mbi legjislacionin në fuqi, të ushtrojnë përgjegjësitë dhe kompetencat, në funksion të interesit të përbashkët dhe publikut;

d) Ata mbajnë përgjegjësi për ligjshmërinë e çdo veprimi apo mosveprimi të tyre, gjatë ushtrimit të detyrës në shërbimin civil, si edhe në fushën e inspektimit financiar publik;

dh) Të inspektojnë në mënyrë kompetente. Ata nuk duhet të marrin përsipër kryerjen e detyrave për të cilat nuk janë kompetentë dhe të aftë profesionalisht për ta realizuar atë me sukses.

Kur caktohen në punë të tilla, duhet të kenë kurajon t’i reklamojnë autoritetit më të lartë ligjor të inspektimit financiar publik;

e) Inspektorët financiarë publikë duhet të respektojnë marrëdhëniet hierarkike me eprorët, vartësit, kolegët e të njëjtit nivel hierarkik dhe mbajtjes së marrëdhënieve korrekte me subjektet e inspektimit;



ë) Të zbatojnë rregullat e etikës në shërbimin publik; të përdorin burimet publike në mënyrë eficiente dhe efektive, si dhe të mos i përdorin ato për qëllime personale; nuk duhet të përdorin pozicionin e tyre zyrtar për të fituar avantazhe që nuk u takojnë, pasurore apo përfitime të tjera;

f) Të kenë një sjellje të mirë dhe të denjë në të gjitha rrethanat, me qëllim respektimin e moralit dhe të ligjit gjatë ushtrimit të funksionit, duke pasur parasysh vetëm interesin publik;

g) Të veprojnë në përputhje me urdhrat e eprorëve hierarkikë, sipas ligjit dhe rregullave të brendshme të njësisë dhe institucionit. Nëse ka dyshime për paligjshmërinë e urdhrat të eprorit, ata nuk e zbatojnë urdhrin, por informojnë pa vonesë eprorin e personit që ka dhënë urdhrin dhe kërkojnë konfirmimin e tij me shkrim, bazuar në aktet përkatëse ligjore në fuqi, me përjashtim të rastit kur zbatimi i tij përbën vepër penale.

4. Ruajtja e sekretit profesional dhe konfidencialiteti:

“Inspektorët financiarë publikë duhet të respektojnë sekretin e informacionit të siguruar dhe nuk duhet ta nxjerrin te palët e treta, pa autorizimin e posaçëm dhe përveçse, kur ka një detyrim ligjor ose profesional. Informacioni sekret nuk duhet të përdoret për përfitime personale të tyre ose të palëve të treta”.

Ruajtja e sekretit profesional dhe konfidencialiteti, kërkon që inspektorët financiarë publikë:

a) Sipas legjislacionit në fuqi, të ruajnë mospërhapjen dhe konfidencialitetin për të dhënat që i janë bërë të ditura, kur ato përbëjnë “Sekret shtetëror”, gjatë edhe pas mbarimit të ushtrimit të detyrës funksionale;

b) Të përdorin dhe të administrojnë me përgjegjësi dokumentacionin që lidhet me objektin e inspektimit. Të marrin masa për ruajtjen e tyre nga zhdukja, fshehja, ndryshimi, falsifikimi dhe veprime të tjera, të cilat synojnë të ndryshojnë ose të asgjësojnë këtë dokumentacion;

c) Në administrimin e dokumenteve ose të fakteve të denoncuar, të zbatojnë parimet e konfidencialitetit. Kur kërkohet nga personi që denoncon praktikën korruptive, të sigurohet ruajtja e anonimatit të tij;

ç) Detyrimi për mbrojtjen, ruajtjen, mospërhapjen, si dhe konfidencialitetin, shtrihet gjatë, edhe pas mbarimit të ushtrimit të detyrës;

d) Të dhënat personale dhe konfidenciale të

subjekteve të inspektimit, duhet t'i përdorin vetëm nëse i nevojiten për realizimin e detyrave funksionale dhe nuk duhet t'i përdorin për përfitim personal;

dh) Të realizojnë sigurinë dhe konfidencialitetin e të gjitha dokumenteve që kanë në ekzaminim. Ata nuk duhet t'i përdorin informacionet e marra gjatë inspektimit për ndonjë përfitim personal, në kundërshtim me ligjin apo që mund të dëmtojë subjektin që auditohet;

e) Të marrin masa të parandalojnë dhe të mbrojnë rrjedhjen e informacionit, të dhënat sensitive dhe konfidenciale, në zbatim të detyrimeve ligjore për mosnxjerrjen apo publikimin e informacionit.

ë) Të gëzojnë lirinë e opinionit personal, por duhet të respektojnë ruajtjen e konfidencialitetit në qëndrimet apo deklaratat me mediat e shkruara dhe elektronike, gjatë gjithë kohës së ushtrimit të funksionit, në zbatim të rregulloreve të institucionit dhe detyrimeve ligjore.

f) Të mos bëjnë publike komente të papërshtatshme, deklarata apo opinione personale që mund të interpretohen si zyrtare, sulme kundër punonjësve të Drejtorisë së Inspektimit Financiar Publik apo ekspertëve të jashtëm që angazhohen në misione të inspektimit financiar publik etj.

ZBATIMI I RREGULLAVE TË KODIT TË ETIKËS

Njohja dhe respektimi i rregullave etike të përcaktuara në këtë Kod, vlerësohen tepër të rëndësishme në arritjen e objektivave të inspektimit financiar publik nga të gjithë inspektorët financiarë publikë, për të rritur besueshmërinë nga subjektet që inspektohen, si dhe nga palët e interesuara.

Parimet dhe sjelljet që nuk janë përmendur në këtë Kod, mund të konsiderohen gjithsesi si cenim i rregullave të etikës, nëse vlerësohen se ndikojnë në besimin e publikut dhe reputacionin e institucionit.

Inspektorët financiarë publikë që nuk respektojnë parimet e etikës sipas këtij Kodi, si dhe të përcaktuara në ligjin për rregullat e etikës në administratën publike, në kodin e procedurave administrative dhe në ligjin për nëpunësin civil, kur veprimet e tyre nuk përbëjnë vepër penale, ndëshkohen me masat disiplinore, sipas procedurave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi që rregullon marrëdhëniet e punës së tyre.

Buletini i Njoftimeve Zyrtare shpërndahet falas në çdo pikë të Postës Shqiptare.
Përmbajtja e Buletinit Zyrtar mund të konsultohet falas dhe pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare.